



## ZYRA E PROKURIMIT

Nr.35/2023

Nr. Protokolli: 49/2023

|               |  |
|---------------|--|
| <b>Për:</b>   | <b>N.P.N. HIDROTERM SH.P.K, Brigada 123, 23000, Suhareke</b> |
| <b>Kopje:</b> | <b>Z.Bali Muharremaj – Kryetar i Komunës së Suharekës</b>    |
| <b>Nga:</b>   | <b>Fatos Kuqi – Shef i zyrës së Prokurimit</b>               |
| <b>Lënda:</b> | <b>VENDIM</b>  |
| <b>Datë:</b>  | <b>09.06.2023</b>  |

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 7 (paragrafi 7.1 pika a) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, **Kërkeses për Rishqyrtim të derguar në Platforme Elektronike të datës: 02.06.2023 të parashtruar nga " N.P.N. HIDROTERM SH.P.K, Brigada 123, 23000, Suhareke lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Projekt me bashkfinancim -Ndërtimi i shtëpisë së Kulturës Ukë Bytyqi faza e dytë-ritender me Nr. të Prokurimi: 624-23-287-5-1-1 & 624-23-02-511 nxjerr këtë:**

### V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e datës 02.06.2023 të parashtruar nga operatori ekonomik: **N.P.N. HIDROTERM SH.P.K, Brigada 123, 23000, Suhareke lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Projekt me bashkfinancim -Ndërtimi i shtëpisë së Kulturës Ukë Bytyqi faza e dytë-ritender me Nr. të Prokurimi: 624-23-287-5-1-1 & 624-23-02-511.**

I.Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AK të publikuar me datë: 31.05.2023

II.Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me dhënie të Kontratës për këtë aktivitetin të prokurimit.

III.Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

## Arsyetim

Autoriteti Kontraktues, Komuna Suhareke me datë **02.06.2023** ka pranuar kërkesë për ri-shqyrtim nga OE" N.P.N. **HIDROTERM SH.P.K, Brigada 123, 23000, Suhareke** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Projekt me bashkëfinancim -Ndërtimi i shtëpisë së Kulturës Ukë Bytyqi faza e dytë-ritender**

Autoritetit Kontraktues pasi shqyrtoi dhe analizoi kërkesen tuaj, vlerëson se pretendimet tuaja nuk qëndrojnë,

1. Përgjigjësja në pretendimin ankimor me Nr.1 sa i përket mos pranimit të kërkesës për zgjatje të vlefshmërisë së Tenderit është e pa bazuar:

Kërkesa e Autoritetit Kontraktues për zgjatje të vlefshmërisë së Tenderit është ngritur në sistemin e e-Prokurimit nga Autoriteti Kontraktues, bazuar në faktin që një kërkesë të tillë u'jan përgjigjur të gjithë Operatorët Ekonomik pjesëmarrës në këtë Aktivitet të Prokurimit për veç jush, dhe si rrjedhojë nuk mund të pretendohet se Kërkesa e AK-ës nuk është dorëzuar te të gjithë pjesëmarrësit në këtë Aktivitet të Prokurimit. Platforma e e-prokurimit nuk mund të jetë selektiv që do të thotë se nuk ka mundësi që te të gjithë Operatorët tjer Ekonomik pranojnë një kërkesë të tillë dhe i përgjigjen të njëjtës vetëm ju si OE nuk e pranoni dhe nuk i përgjigjeni një kërkesë të tillë. Është e vërtetë që kërkesa nga AK është dorëzuar te OE me datë 23.05.2023 e që afati i fundit i skadimit të ofertave ka qenë data 21.05.2023 ditë e diel, Megjithatë një gjë e tillë nuk ka ndodhur nga neglizhenca apo mos kujdesi i Autoritetit Kontraktues, por shkak i vonësës 1 ditore ka qenë **Ministria e Kulturës, Rinis dhe Sportit** për shkak të mos zotimit të mjeteve për pjesën e saj të bashkëfinancimit (ju lutem shih komunikimet e bashkangjitura ne mes të AK dhe Ministres në fjalë), dhe gjithashtu Autoriteti Kontraktues për përgjigjësjen në vazhdim të validitetit të tenderve nga OE-të ka pritur 8 ditë që do të thot se AK ka ofruar kohë të mjaftueshme për përgjigjësje.



Tor: Jehona Shyti  
Cc: Baki Muharemaj

1 attachment



Te nderuar,

Uroj te jeni mire,

Në bazë të memorandumit të Bashkëpunimit lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Komunes së Suharekes me nr. të protokollit të Ministrisë së Kulturës 2616/2020 të datës 30.07.2020 dhe nr të protokollit të Komunes së Suharekes 01.016.32751 të datës 30.07.2020 të nëshkruar nga ministria Vlora Dumoshi dhe kryetërit të Komunes së Suharekes Bali Muharemaj dhe Aneks Memorandumit të bashkëpunimit të lidhur ndërmjet institucioneve të lartëcekura me nr protokollit të ministrisë 3842-2022 të datës 30.08.2022 dhe nr protokollit të Komunes së Suharekes 01.016.56777 të datës 30.08.2022.

Kërkojme nga ju që të zotoni mjete për këto aktivitet të prokurimit: Ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës "Ukë Bytyqi" faza e dytë, pasi që nuk po mund të vazhdojmë para pa zotim të mjeteve nga ana jua).

Bashkëngjitur ne attach i gjieni te dyja ma rreveshjet e anjtura.

Me respekt

Zyra e Prokurimit  
Komuna Suhareke  
email: zprokurimi@suhareke@ns-gov.net  
Tel: 029 271 026

Kerkes per Zotim

← REPLY ←← REPLY ALL → FORWARD ...



Zyra Prokurimit Suhareke

Fri 5:19/2023 9:41 AM

Send Mail...

Mark as unread

To: Jehona Shyti

Cc: Bali Muharremaj

1 attachment



Pershendetje

Uroj te jeni mire

Në bazë të memorandumit të Bashkëpunimit lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Komunes së Suharekes me nr. të protokollit të Ministrisë së Kulturës 2616/2020 të datës 30.07.2020 dhe nr të protokollit të Komunes së Suharekes 01.016.32751 të datës 30.07.2020 të nëshkruar nga ministrija Vlora Dumoshi dhe kryetari të Komunes së Suharekes Bali Muharremaj dhe Aneks Memorandumit të bashkëpunimit të lidhur ndërmjet institucioneve të lartëcekura me nr protokollit të ministriisë 3842-2022 të datës 30.08.2022 dhe m nr protokollit të Komunes së Suharekes 01.016.5677 të datës 30.08.2022.

AK ka pranuar Deklaratën e disponueshmërisë së fondeve për këtë aktivitet, por kërkojmë nga ju që të bëni edhe zotimin e mjeteve pasi që nuk po mundemi të vazhdojmë para për këtë aktivitet.

Me respekt

Zyra e Prokurimit

Komuna Suharekë

email: zprokurimit.suhareke@rks.gov.net

Tel: 029 371 026



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA  
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT  
MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I SPORTI  
MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORT

### FORMULAR PËR KËRKESË

Ju lutemi dorëzojeni në zyrën e Sekretarit të përhershëm pasi ta keni plotësuar seksionin A dhe B

|              |              |                      |
|--------------|--------------|----------------------|
| Emri         | Jehona Shyti | Data : 22.05.2023    |
| Nënshkrimi   |              | Nr. i tel: 044589549 |
| Departamenti | i Kulturës   | Nr. i ID:            |

#### A : Detajet e kërkesës

Lloji i kërkesës :  
Pajisje / Material  
Shërbim  
IT Pajisje  
 Punë

(Vërejtje A (Vërejtje : Artikujt e kërkuar në formularin për kërkesë duhet të jenë të llojit apo të kategorisë së njëjtit. Një formular kërkesë i ndarë duhet të plotësohet për secilin lloj të ndryshëm të kërkesës. P.sh. mos e bëni kërkesën për biznes kartë së bashku me kërkesën për marrjen me qira të hapësirës për zyra)

#### Përshkrimi i preciz

Kërkojmë nga zyra e financave që të përgatisë zotimin e mjeteve që ka të bëjë me Projektin Ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës Ujë Bytyqi në Suharekë, me kod 15382

Shuma totale që kërkohet është 500,000 €

Zotimi të bëhet në dy kështe

Justifikimi (kërkuar) (Përdorni fleta shtesë nëse ju duhet më shumë)

#### B : Aprovim nga drejtori i departamentit përkatës

Emri dhe mbiemri : znj. Jehona Shyti, Drejtoreshë e Departamentit të Kulturës

Data : 22/05/2023

Nënshkrimi :

#### C : Autorizimi

Emri dhe mbiemri : Feim Hoxha - Zv. Sekretar i Përgjithshëm

Data : 22/05/2023

Nënshkrimi :

APROVOHET



NUK APROVOHET



Kerkese - Ndertimi shtepise se Kultures Uke Bytyqi ne Suhareke



To: Zyra Prokurim, Suhareke, Safi Muharemaj

1 attachment



Sent from my iPhone

Begin forwarded message:

From: Dafina Rexhepi <Dafina.Rexhepi@rks-gov.net>  
 Date: 24 May 2023, 2:49:24 PM, CEST  
 To: Jehona Shyti <Jehona.Shyti@rks-gov.net>  
 Subject: Kerkese - Ndertimi shtepise se Kultures Uke Bytyqi ne Suhareke

E nderuar drejtoreshe,

Bashkengjitur gjeri kerkese "Ndertimi i shtepise se Kultures Uke Bytyqi ne Suhareke"

Dafina

Republika e Kosoves  
 MINISTRIA E KULTURES, RINIAJE DHE SPORTIT  
 KERKESHE PER MALLRA DHE SHERBIME

|   |                                   |                               |
|---|-----------------------------------|-------------------------------|
| Kodi i kontratimit: 00300                               | Titulli i kontratimit: 0031-20231 | No. i kontratimit: 0033-20231 |
| Titulli i kontratimit: PERBLERJE SHITESITJE PER KULTURE | Data e kontratimit: 24/05/2023    | Perdoruesi:                   |
| Referenca:  | Adresa e objektit:                |                               |

Përshkrim i i shprehur:

**SHITESITJA NDERTIMI I SHITESISE SE KULTURES DHE SHITESISE BUMARENE**

| Nr. i artikullit  | Përshkrim i i shprehur i artikullit                                | Data e kontratimit |            |       | Cena / vlerat |            | E tregu |
|-------------------|--|--------------------|------------|-------|---------------|------------|---------|
|                   |  | Pril               | Qers       | Qers  | Vendore       | Vendore    |         |
| 1                 | SHITESITJA NDERTIMI I SHITESISE SE KULTURES DHE SHITESISE BUMARENE | 23/05/2023         | 31/10/2023 | 06/01 | 250 000.00    | 100 000.00 |         |
| Shuma kontraktit: |  |                    |            |       |               | 500 000.00 |         |

SHIFRACIONE SPECIALE

AVULE PAVRE

METODA E PROKURIMIT  
 VLERESIME PUNE PADRINI PALLJETIM

Perdoruesi i kontratimit dhe kontratit me organizatorin bashkepunues:  
 [Signature] 24.05.2023  
 Data

Republika e Kosoves  
 Ministria e Financave  
 Drejtoria e Mbledhjes se Ministrave - Ministry of Finance  
 Theksimi i Shumave - Treasury Section - Treasury of Kosovo

Kerkesa Zbatimi per Shlyerje  
 (Për blerjen e mallrave dhe shërbimeve)

|                                   |                                |                               |
|-----------------------------------|--------------------------------|-------------------------------|
| Emri i kontratimit: 00300         | No. kontratimit: 0033-20231    | No. i kontratimit: 0033-20231 |
| Titulli i kontratimit: 0031-20231 | Data e kontratimit: 24/05/2023 | Perdoruesi:                   |

Referenca:

Adresa e objektit:

| Nr. i artikullit  | Përshkrim i i shprehur i artikullit                                | Data e kontratimit |            |       | Cena / vlerat |            | E tregu |
|-------------------|--|--------------------|------------|-------|---------------|------------|---------|
|                   |  | Pril               | Qers       | Qers  | Vendore       | Vendore    |         |
| 1                 | SHITESITJA NDERTIMI I SHITESISE SE KULTURES DHE SHITESISE BUMARENE | 23/05/2023         | 31/10/2023 | 06/01 | 250 000.00    | 100 000.00 |         |
| Shuma kontraktit: |  |                    |            |       |               | 500 000.00 |         |

SHIFRACIONE SPECIALE

AVULE PAVRE

METODA E PROKURIMIT  
 VLERESIME PUNE PADRINI PALLJETIM

Perdoruesi i kontratimit dhe kontratit me organizatorin bashkepunues:  
 [Signature] 24.05.2023  
 Data

pra shkak i vonesës së paraqitjes së kërkesës për vazhdim të validitetit të ofertave ka qen mos siguria e AK-ës në lidhje me posedimin e mjeteve. Sipas nenit 30.6 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik mundësia e Operatorëve Ekonomik është e hapur të vendosë nëse dëshiron të zgjatë validitetin e tenderit. Për vet faktin që ju si Operator Ekonomik nuk ju keni përgjigjur pozitivisht kërkesës së AK-ës për vazhdim të validitetit, AK ka vepruar në bazë të po këtij neni duku ju shpallur ju si Operator Ekonomik të pa përgjegjshëm. Neni 30.6 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, përcakton si në vijim citoi:

*“Është e hapur për secilin OE të vendosë nëse dëshiron të zgjatë validitetin e tenderit. OE të cilët vendosin të mos zgjasin validitetin e tenderëve të tyre do të refuzohet si “të papërgjegjshëm” dhe kështu AK nuk do të konfiskoj Sigurimin e Tenderit të tyre”.*

2. Përgjegjëja e AK-ës sa i përket pretendimit të dytë (2) ankimor, në lidhje me përshtatshmërinë e OE-ve (neni 65 i LPP-ës) gjegjësisht vërtetimit të Gjykatës të ofruar nga Operatorit Ekonomik i rekomanduar për Kontratë nuk qëndron dhe është i pa bazuar ngase vërtetimi i tillë i lëshuar nga Gjykata Kompetente potencon shprehimisht se dënimi përfundimtar me GJOB nuk ka pasoja juridike dhe është nxjerr për veprë penale të shkaktuar në trafik gjë që sipas interpretimit të KRPP-ës të publikuar në ueb-faqen e e-prokurimit të informacionet me datë 22.11.2022 nuk qon peshe në këtë Aktivitet të Prokurimit. Interpretimi I lartë përmendur përcakton si në vijim:

*“Konform nenit 87, paragrafit 2, nën-paragrafit 2.7 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP ofron interpretim ligjor si në vijim:*

*Neni 65, paragrafi 3, nën-paragrafi 3.1 i LPP-së, përcakton:*

*“3. Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluara:*

*3.1. Është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një veprë penale ose civile duke përfshirë praktikën e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme me ato të përshkruara në paragrafin 1. të nenit 130 të këtij ligji sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Kosovë ose në cilindo shtet, ose në çfarëdo marrëveshje ose konvente ndërkombëtare;”*

*Sipas nenit të lartë përmendur Autoriteti Kontraktues do ta konsideroj të papërgjegjshëm çdo OE që:*

- 1) ka kryer disa vepra penale të caktuara apo vepra civile.*
- 2) bien në rastet e parashikuara me nenin 130.1 (ndikimi i paligjshëm).*
- 3) është dënuar për rastet e parashikuara nga marrëveshje ose konventa ndërkombëtare.*

*Përderisa rrethanat në pikën 2 dhe 3 janë mjaft të qarta, rrethanat në pikën 1 duhet të qartësohen.*

*Në veçanti neni 65, paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 i LPP-së parasheh përjashtimin automatik të OE që kanë pozita përkatëse vendimmarrëse (pozita ekzekutive, menaxhuese ose drejtor ) që kanë kryer në dhjetë vitet e fundit vepra penale ose civile duke përfshirë praktikën e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme me ato të përshkruara.*

*Pra refuzimi automatik i OE vlen vetëm për veprat penale të kryera në dhjetë vitet e kaluara që përfshijnë larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe. Është e drejtë e autoritetit kontraktues për të përcaktuar përmes qasjes në regjistrin penal për të dëshmuar pranueshmërinë e OE për rrethanat e mësipërme. Në këto raste përjashtimi vepron mbi baza automatike për çdo lloj të kontratës, për shkak se rëndësia e këtyre krimeve përfshin një pasiguri automatike të OE në fjalë për të kontraktuar me Administratën Publike.*

*Për të gjitha veprat penale të cilat nuk përfshihen në pikën e mëparshme (pikën 1) LPP nuk sqaron asgjë më shumë .*

*Për këtë arsye KRPP, konsideron se Autoriteti Kontraktues duhet të vlerësoj vetë për veprat tjera penale apo civile të kryera nga Operatorët Ekonomik se vepra penale apo civile në fjalë është aq e rëndësishme që të përfshijë mospranimin e të drejtës se OE për atë kontratë të veçantë. Në mënyrë që të përcaktohet prunueshmëria apo jo e OE, AK duhet të vlerësojë nëse sjellja kriminale ka një lidhje me kontratën e veçantë, nëse sjellja është kryer gjatë ushtrimit të profesionit të tij, serioziteti i sjelljes kriminale, mungesën për krime të tjera të së njëjtës natyrë, etj*

*Për shembull, një vepër penale e përbërë nga ngasja e një makine nën ndikimin e alkoolit ose drogës nuk është e rëndësishme për një kontratë që ka si subjekt prokurimin e kompjuterëve, por mund të jetë e rëndësishme për një kontratë që ka si subjekt qiramarrjen e makinave me shoferë.*

*Ose për shembull, një vepër penale që konsiston në mos respektimin e rregullave në lidhje me ruajtjen dhe magazinimin e ushqimit nuk është e rëndësishme në një kontratë që ka për lëndë furnizim me derivate, por mund të jetë e rëndësishme për një kontratë që ka si lëndë furnizim me artikuj ushqimor”.*

3. Përgjigjësja e AK-ës sa i përket pretendimit ankimor me Nr.3 Gjithashtu nuk qëndron ngase Grupi i Operatorëve Ekonomik i rekomanduar për dhënie të Kontratës ka ofruar të gjitha Deklaratat e kërkuara për Grupin e Operatorëve Ekonomik si në vijim:
  - a. Deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës.
  - b. Deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë në mënyrë individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit.
  - c. Deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit.
4. Përgjigjësja e AK-ës Pretendim Ankimor me Nr.4 i parashtruar nga ana juaj Për Autoritetin Kontraktues është i pa bazuar ngase Kërkesa dhe Dëshmia sa i përket Kërkesave mbi gjendjen Ekonomike dhe Financiare në Dosjen e Tenderit nga Autoriteti Kontraktues është përcaktuar si në vijim:

**Kërkesa 2 - Operatori Ekonomik duhet të ketë mjete financiare të mjaftueshëm për realizimin e kontratës, mjete të gatshme në bankë në vlerë prej së paku 1,000,000.00 € ose dëshmi mbi akses në kredi nga një Banke, për të njëjtën vlerë (1,000,000.00 €) në emër të të njëjtit Aktivitet të Prokurimit**

**Ndërsa Dëshmia:**

**Dëshmia 2 - Dokument i lëshuar nga institucioni bankar i cili dëshmon se Operatori Ekonomik posedon mjetet e gatshme financiare në bankë ose Dokument i lëshuar nga institucioni bankar i cili dëshmon se Operatori Ekonomik do të ketë akses në kredi për të njëjtën vlerë (1,000,000.00 €) në emër të të njëjtit Aktivitet të Prokurimit. Dokumenti duhet të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni bankar lidhur me këtë projekt.**

Bazuar në dëshminë e ofruar nga Grupi i Operatorëve Ekonomik i rekomanduar për Kontratë, Autoriteti Kontraktues, gjegjësisht Komisioni Vlerësues ka vlerësuar se dokumenti i Ofruar nga GOE i rekomanduar për Kontratë i lëshuar nga Institucioni bankar e plotëson kërkesën e vendosura në FDT, Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare, ngase i njëjti dokument është lëshuar për Aktivitetin e Prokurimit në fjalë i nënshkruar dhe i vulosur ashtu

siç është kërkuar. Autoriteti Kontraktues nuk ka kërkuar që Operatori Ekonomik të ofroi Kërkesë për qasje në kredi, por thjesht një dokument nga banka (pa marr para sysh emërtimin e tij) që dëshmon që OE në fjalë do të ketë qasje në kredi nëse kërkon. Institucioni bankar neper mes shpresës se lëshuar ka pohuar mbështetje financiare për projektin në fjalë bazuar në kapacitetin e OE financiar të bërë nga analistët e bankës dhe ka potencuar se do ta konsideroi mbështetjen financiare për shumën e kërkuar. Për më tepër Autoriteti Kontraktues ju informon se gjatë fazës së vlersimit të këtij Aktiviteti të Prokurimit për ta siguruar vërtetësin e dokumentit në fjalë ju ka drejtuar institucionit bankar në fjalë me që rast i njëjti ka konfirmuar vërtetësi e të njëjtit dokument ( shih e-mailat komunikues të bashkangjitur).

← REPLY   ← REPLY ALL   → FORWARD   ...



Zyra Prokurimit Suhareke

Wired 31-1522323 1300 AKS

Send items

Mark as unread

To: raymond.prensaj@proced-t-group.com <Raymond.Prensaj@proced-t-group.com>

1 attachment



Te nderuar,

Komuna e Suharekës, Zyra e Prokurimit ka hapur tender për ndërtimin me titull: **Projekt me bashkëfinansim -Ndërtimi i shtëpisë së Kulturës Ujë Bytyqi** faza e dytë-tender me numer të prokurimit: 424-23-287-S-1-1 & 424-23-02-S-1-1, andaj dhe Operatorët Ekonomik kanë ofertuar lidhur me këtë projekt.

Ne, si Autoritet Kontraktues i shqyrtojmë ofertat e Operatorëve Ekonomik dhe i analizojmë dokumentacionet e kërkuara sipas kriterëve. Për këtë kemi kërkuar edhe Letrën e Referencës për mbështetje financiare të Operatorëve të cilët ofertojnë.

Andaj, ne kërkojmë nga ju të na vërtetoni, verifikoni dhe ta konfirmoni dokumentacionin në fjalë të cilin e gjeni në atach e të cilin dokument e ka sjellur Operatori Ekonomik, që përmbanë shifrën prej 1.000.000.00 euro, të lëshuar nga Institucioni juaj.

Presim që të bashkëpunojmë në informatat e kërkuara lidhur me këtë kërkesë.

Faleminderit për kohën...

Me respekt

Zyra e Prokurimit  
Komuna Suhareke  
e-mail: zprokurimit.suhareke@ks.gov.net  
Tel 029 271 026



Bazuar në të dhënat e lartë përmendura dhe bazuar në nenin 56.3 të LPP-ës i cili përcakton se :

*Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.*

Autoriteti Kontraktues e hedh poshtë pretendimin tuaj ankimor dhe konsideron se dëshmia e ofruar nga Operatori Ekonomik e plotëson kërkesën e përcaktuar nga AK në FDT.

5. Përgjigjeja e AK-ës sa i përket pretendimit ankimor me Nr. 5. në lidhje me referencat e ofruara nga GOE ku pretendohet se referencat e ofruara nga GOE (për Ndërtim të lartë) nuk e plotësojnë shumën e kërkuar nga AK dhe disa nga to nuk i përkasin Ndërtim të lartë, **gjithashtu nuk qëndron ngase GOE e plotëson kërkesën e AK-ës qoft në shumë të përcaktuar po ashtu edhe për nga natyra e kërkuar. Gjatë vlerësimit të AP në fjalë po ashtu edhe gjatë rishqyrtimit të kërkesës tuaj të parashtruar në bazë të nenit 108/A sa i përketë këtij pretendimi AK ka konstatuar se shumica e kërkuar është përmbushur me referencat e ofruara nga GOE dhe se natyra e referencave që e plotësojnë këtë shumë janë të natyrës së kërkuar qoft si ndertime të objekteve apo qoft riparime (punë) në ndërtim të objekteve që bien në fushveprimin e ndërtimeve të larta.**
6. Përgjigjeja e AK-ës sa i përketë pretendimit ankimor me Nr.6 me çë rast pretendohet se Konzerciumi i rekomanduar për Kontratë nuk ka ofruar deklaratën me të cilën dëshmon se mjetet e cilat planifikon ti përdorë jone ne gjendje te mire operationale gjithashtu nuk qëndron.

Operatori Ekonomik ka ofruar një deklaratë (edhe pse nuk përcakton shprehimisht fjalën pajisjet) me të cilën deklaroi se artikujt për këtë projekt janë në pajtueshmeri të plotë me kërkesat dhe specifikimet teknike të përcaktuara në Dosjen e tenderit, me çë rast mos përcaktimi shprehimisht i fjalës **pajisje për AK konsiderohet devijim i vogël, duke u bazuar**

në nenin 59.4 e LPP-ës i cili ndër të tjera përcakton si në vijim: Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. **Pavarësisht nga e mëparshmjja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse tenderit në fjalë, përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.**

Construmax SH.P.K-Suharekë & Harst Group SH.P.K-Suharekë dhe EBK SH.P.K-Prizren



### DEKLARATË

*Kontraktuesit firmë Construmax SH.P.K dhe Harst Group SH.P.K dhe EBK SH.P.K deklarimet që arrijnë për këtë projekt për të pajtimshëm të plotë me specifikat teknike të përshtrura në DT dhe përmasat paralele të. Çdo deklarim deklarim që të gjitha kontraktet të cilët do të vendosen në objekt, përfshirë të të përcaktuar certifikatat dhe të tjerat që specifikohen*

|                        |  |
|------------------------|--|
| Projekti:              | Projekt me bashkfinancim -Ndërtimi i shtepisë së Kulturës Ujë<br>Dytyqi faza e dytë-ritender |
| Numri i Prokurimit:    | 624-23-287-5-1-1   |
| Numri i brendshëm:     | 624-23-02-5-1-1  |
| Autoriteti Kontraktues | KOMUNA SUHAREKË  |

Construmax SH.P.K-Suharekë  
Menaxherë Besë Krautiqi  
v.v



HARST Group SH.P.K  
Drejtor Sedik Ramadani  
v.v



EBK SH.P.K-Prizren  
Drejtor Flamur Shefik  
v.v



Data: 21.02.2023

- Përgjigjeja e AK-ës sa i përket pretendimin ankimore me Nr.7 (i fundit) në lidhje me planin dinamik gjithashtu është i pa qëndrueshem. Plani Dinamik i ofruar nga Grupi i Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë është i detajuar dhe përputhet plotësisht me kërkesën e parashtruar në Dosjen e Tenderit. GOE ka ofruar plan dinamik të nënshkruar dhe të vullosur, ka përfshirë numrin e puntorëve që do të angazhohen në secilin pozicion, ditët e nevojshme për realizimin e pozicioneve si dhe ditët e pushimit dhe të festave zyrtare varsisht nga data e fillimit të punimeve (gjë që është subjektive dhe nuk mund të parashihet për shkak të proceseve të ndërlikuara të Prokurimit) që do të respektohen sipas ligjit të punës (si kusht social).

Andaj bazuar në të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Shef i zyrës së Prokurimit  
Fatos Kuqi

